

Hapet Thirrja për Bursa për stafin e UMT, në Programin Erasmus +, në Universitetin e Malagës, Spanjë

Kohëzgjatja e mobilitetit dhe llojet e mobilitetit

Periudha e mobilitetit për stafin është 5 ditë me 2 ditë për udhëtim, duke mbuluar gjithsej 7 ditë. Mobiliteti i stafit mund të jetë për mësimdhënie, trajnime ose të dyja.

- Gjatë mobilitetit për mësimdhënie (STA), stafi duhet të japë të paktën 8 orë mesim në javë.
- Gjatë mobilitetit për trajnim (STT), stafi duhet të trajnohet, duke u angazhuar në aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin profesional si trajnime.
- Mobiliteti mund të kombinojë dhe mësimdhënie dhe trajnim. Në këtë rast minimumi i orëve të mësimdhënies janë 4 orë.

Kush mund të aplikojë:

- Stafi akademik nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT
- Stafi akademik nga Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës
- Stafi akademik nga Fakulteti i Ekonomisë
- Gjithë stafi administrativ

Gjuha e mësimdhënies/trajnimit

- Gjuha e mësimdhënies do të jetë në anglisht dhe stafi duhet të zhvillojë të paktën 8 orë mësimdhënieje
- Gjuha e trajnimit do të jetë në anglisht.

Bursat përfshijnë:

- Mbështetje individuale për stafin. Shuma është 160 euro në ditë. Periudha e pranueshme është 5 ditë qëndrim + 2 ditë udhëtim (1 ditë nisje dhe 1 ditë kthim).
- Mbështetje shtesë për udhëtimin

Ju mund të përdorni linkun e EACEA si më poshtë për të llogaritur distancën.

http://ec.europa.eu/programmes/erasmusplus/tools/distance_en.htm

Travel distance	Amount per participant
Between 10 and 99 Km	20 Euros
Between 100 and 499 km	180 Euros
Between 500 and 1999 km	275 Euros
Between 2000 and 2999 km	360 Euros
Between 3000 and 3999 km	530 Euros
Between 4000 and 7999 km	820 Euros
8000 km or more	1.500 Euros

Dokumentet për aplikim

1. Kopje e pasaportës
2. Vërtetim Punësimi
3. Plani i mobilitetit
4. CV dhe lista e publikimeve

Anëtarët e stafit që nuk marrin pjesë në asnjë nga javët ndërkombëtare të stafit të organizuar nga Zëvendës-Rektorati për Mobilitetin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar, të cilët dëshirojnë të vendosen në Universitetin e Malagës, duhet të kontaktojnë profesorët e fakulteteve të interesit të tyre për të organizuar dhe për të marrë pranimin e tyre:

- Kontakti i universitetit në UMA: <http://u.uma.es/cZP/>
- Departamentet e UMA: <http://u.uma.es/cZS/>

Ju gjithashtu mund t'i referoheni thirrjes online:

https://www.uma.es/media/files/normalized_report_CALL_Abreviada_STT_STA_INCOMING_SM_2101022.pdf

Afati për aplikime: 15 Nentor, 2025

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë fizikisht dhe me e-mail në iro-projects@umt.edu.al.

UMT ju uron suksese me aplikimin tuaj!